



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 317, datë 4.6.2025

P Ë R

MIRATIMIN E PROGRAMIT KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE
TË PUNËS NË ADMINISTRATËN SHTETËRORE
DHE INSTITUCIONET E TJERA PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 14/2, të ligjit nr.75/2019, "Për rininë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky vendim ka si objekt miratimin e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës në Administratën Shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, dhe institucionet e tjera publike për profesionistë të rinj (në vijim referuar si "Programi Kombëtar i Praktikave të Punës").

Neni 2

1. Programi Kombëtar i Praktikave të Punës synon të përfshijë pjesëmarrësit në një eksperiencë pune të integruar e në ndërveprim me profesionistë karriere në administratën publike, me qëllim përfitimin e një përvoje kualifikuese që ndikon në zhvillimin e aftësive të tyre profesionale e të shprehive të tyre praktike në njohje me sistemin administrativ publik.
2. Kriteret, që duhet të plotësojë aplikanti për t'u bërë pjesë e këtij programi, janë,

si më poshtë vijon:

- a) Të jetë i ri nga mosha 21 deri në 29 vjeç;
- b) Të jetë diplomuar në një program studimi të ciklit të parë apo të ciklit të dytë, të ofruar nga një institucion i arsimit të lartë;
- c) Të mos ketë qenë pjesë e programit në thirrjet e mëparshme;
- ç) Të mos ketë qenë i punësuar në institucionet e administratës shtetërore apo institucione të tjera publike në të shkuarën, me përjashtim të punësimit si punonjës administrativ, në kuptim të shkronjës “d”, të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

3. Programi Kombëtar i Praktikave të Punës, për çdo thirrje vjetore, përbëhet nga:

- a) periudha 3 (tre)-muajore e praktikës;
- b) periudha 1 (një)-vjeçare e punësimit me kontratë.

4. Periudha 3 (tre)-muajore e praktikës dhe periudha 1 (një)-vjeçare e punësimit me kontratë në kuadër të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës njihen si përvojë pune gjatë procedurave të rekrutimit në institucionet e administratës publike.

II. REALIZIMI I PROGRAMIT DHE TRAJTIMI I PRAKTIKANTËVE

Neni 3

- 1. Programi Kombëtar i Praktikave të Punës realizohet nga ministria përgjegjëse për rininë, e cila mbështetet nga institucionet e administratës shtetërore dhe institucione të tjera publike që ofrojnë gatishmëri për pranimin e praktikantëve. Ministria përgjegjëse për rininë kryen rolin e sekretariatit teknik të programit për koordinimin ndërinstitutional.
- 2. Programi Kombëtar i Praktikave të Punës realizohet për çdo thirrje vjetore, sipas planveprimit dhe metodologjisë së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
- 3. Shpallja e thirrjes vjetore dhe procesi i aplikimit për profesionistët e rinj realizohet përmes platformës zyrtare elektronike të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, që administrohet nga ministria përgjegjëse për rininë.

Neni 4

- 1. Institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e tjera publike, që mbështesin këtë program, përcaktojnë numrin e praktikantëve të kërkuar dhe

profilin e tyre.

2. Të gjitha institucionet pjesëmarrëse në këtë program kanë për detyrë të përcaktojnë 1 (një) person kontakti, i cili është përgjegjës për:
 - a) dorëzimin pranë ministrisë përgjegjëse për rininë të numrit të praktikantëve për çdo thirrje;
 - b) krijimin e kushteve të nevojshme për mbarrëvajtjen e programit;
 - c) komunikimin me ministrinë përgjegjëse për rininë;
 - ç) koordinimin e pjesëmarrjes së praktikantëve në programin e posaçëm të trajnimit;
 - d) përcjelljen pranë ministrisë përgjegjëse për rininë të listës emërore të praktikantëve që përfshihen në thirrjen vjetore të programit, brenda 5 (pesë) ditëve punë nga nënshkrimi i marrëveshjes për zhvillimin e praktikës 3 (tre)-muajore dhe nënshkrimi i kontratës 1 (një)-vjeçare të punës.
3. Për institucionet e administratës publike, pjesë të shërbimit civil, personi i kontaktit duhet të jetë nëpunës civil i konfirmuar. Për institucionet e tjera, ai duhet të ketë eksperiencë pune të paktën 3 (tre) vjet.
4. Të gjitha institucionet pjesëmarrëse në këtë program kanë për detyrë të caktojnë 1 (një) mbikëqyrës për çdo praktikant të pranuar.
5. Mbikëqyrësi i praktikantit ka përgjegjësitë e mëposhtme:
 - a) Të përcaktojë detyrat dhe angazhimet për praktikantin;
 - b) Të mbikëqyrë, të këshillojë dhe të udhëzojë praktikantin gjatë realizimit të detyrave të dhëna;
 - c) Të vlerësojë performancën e praktikantit gjatë praktikës;
 - ç) Të përgatisë vlerësimin përfundimtar për praktikantin;
 - d) Të gjykojë për arsyet e përfundimit të programit nga ana e praktikantit në rast shkeljeje të marrëveshjes midis institucionit dhe praktikantit.
6. Për institucionet e administratës publike, pjesë të shërbimit civil, mbikëqyrësi i praktikantit duhet të jetë nëpunës civil i konfirmuar. Për institucionet e tjera, ai duhet të ketë eksperiencë pune të paktën 2 (dy) vjet.

Neni 5

1. Numri i praktikantëve, që përfshihen në periudhën 3 (tre)-muajore të praktikës në kuadër të thirrjes vjetore të Programit Kombëtar të Praktikave të punës, në çdo rast, nuk është më shumë se 600 (gjashtëqind) praktikantë. Gjatë periudhës së kryerjes së praktikës, praktikanti përfiton:

- a) trajtim ushqimor në formën e kompensimit financiar;
- b) trajnim në kuadër të një programi të posaçëm trajnimi pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (referuar në vijim ASPA).

2. Vlera ditore e kompensimit financiar të përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij neni, është 500 (pesëqind) lekë dhe i akordohet praktikantit për çdo ditë praktike të kryer prej tij. Pagesa e kompensimit financiar kryhet nga Agjencia Kombëtare e Rinisë, e cila programon në buxhetin e saj fondet e nevojshme për këtë qëllim.

3. Me qëllim kryerjen e pagesës së kompensimit financiar:

- a) ministritë koordinojnë me institucionet e sistemit të tyre ministror për mbledhjen e listëprezencave mujore me numrin e ditëve efektive të praktikës së kryer nga çdo praktikant i angazhuar në këto institucione dhe me të dhënat e përditësuara të llogarive bankare të praktikantëve dhe i raportojnë ato pranë Agjencisë Kombëtare të Rinisë, brenda datës 5, të muajit pasardhës;
- b) institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore raportojnë drejtpërdrejt pranë Agjencisë Kombëtare Rinisë brenda datës 5 (pesë), të muajit pasardhës, të njëjtat të dhëna të përcaktuara në shkronjën "a", të kësaj pike, për praktikantët pranë institucioneve të tyre.

4. Agjencia Kombëtare e Rinisë përlllogarit shumën e kompensimit financiar mbi bazë mujore dhe e transferon atë në llogarinë bankare të praktikantit, në një bankë të nivelit të dytë.

5. Programi i posaçëm i trajnimit sipas shkronjës "b", të pikës 1, të këtij neni, hartohet nga ASPA, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për rininë, bazuar në vlerësimin e njohurive e të kapaciteteve të nevojshme për angazhimin e profesionistëve të rinj pranë institucioneve të administratës shtetërore. Pjesëmarrja në programin e trajnimit përfshihet në vlerësimin përfundimtar të praktikantit.

6. Programi i posaçëm i trajnimit të praktikantëve zhvillohet, në përputhje me rregullat dhe procedurat e ndjekura nga ASPA. Praktikanti pajiset me certifikatën e trajnimit, me përfundimin e suksesshëm të programit të trajnimit.

7. Pagesa për pjesëmarrjen e çdo praktikanti në programin e posaçëm të trajnimit përlllogaritet, në bazë të tarifës së miratuar për përgatitjen paraprake të kandidatëve për të marrë pjesë në konkurrimin e hapur për kategorinë

ekzekutive dhe kryhet nga Agjencia Kombëtare e Rinisë në bazë të faturës së lëshuar nga ASPA.

Neni 6

1. Në përfundim të periudhës 3 (tre)-muajore të praktikës, deri në 250 (dyqind e pesëdhjetë) nga praktikantët e thirrjes vjetore të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës përzgjidhen nga institucionet ku kanë kryer praktikën për t'u punësuar me kontratë pune 1 (një)-vjeçare.
2. Përzgjedhja e praktikantëve të thirrjes për efekt të punësimit me kontratë pune 1 (një)-vjeçare është, si më poshtë vijon:
 - a) deri në 200 (dyqind) praktikantë për institucionet e administratës shtetërore;
 - b) deri në 50 (pesëdhjetë) praktikantë për institucionet e tjera publike.
3. Praktikanti për t'u punësuar me kontratën 1 (një)-vjeçare të punës duhet të ketë përmbyllur me sukses praktikën 3 (tre)-muajore dhe programin e trajnimit pranë ASPA-s.
4. Përzgjedhja e praktikantëve kryhet nga secili institucion pjesëmarrës, bazuar në vlerësimin e performancës së tyre në praktikën 3 (tre)-muajore.
5. Ministria përgjegjëse për rininë administron procesin e punësimit të praktikantëve në thirrjen vjetore për institucionet e administratës shtetërore dhe për institucionet e tjera publike, bazuar në kërkesat e institucioneve për punësimin e praktikantëve dhe numrin e praktikantëve që kanë kryer me sukses periudhën 3 (tre)-muajore të praktikës.
6. Ministria përgjegjëse për rininë dërgon në ministrinë përgjegjëse për financat numrin e praktikantëve që do të punësohen në çdo institucion të administratës shtetërore dhe institucion tjetër publik, në kuadër të këtij programi për çdo vit buxhetor. Ministria përgjegjëse për financat njofton degët e thesarit për numrin e praktikantëve që do të paguhen brenda fondeve të miratuara për institucionin përkatës në ligjin vjetor të buxhetit.
7. Praktikantët e punësuar, për efekt pagese, klasifikohen jo më lart se niveli i specialistit të kategorisë IV-3.
8. Fondet e nevojshme financiare për punësimin 1 (një)-vjeçar përballohen nga fondet e buxhetit, të miratuara për secilin institucion për shpenzimet e personelit, për vitin përkatës.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 7

1. Në përfundim të çdo thirrjeje, ministria përgjegjëse për rininë raporton pranë Departamentit të Administratës Publike të dhënat për çdo praktikant, që ka kryer me sukses periudhën 3 (tre)-muajore të praktikës/dhe për çdo praktikant të punësuar me kontratë pune 1 (një)-vjeçare.
2. Vendimi nr.395, datë 29.4.2015, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike", i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 8

Ngarkohen ministria përgjegjëse për rininë, Ministria e Financave, Agjencia Kombëtare e Rinisë, Departamenti i Administratës Publike, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike dhe të gjitha institucionet e administratës publike, të përfshira në program, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

BELINDA BALLUKU

**MINISTRI I SHTETIT
PËR RININË DHE FËMIJËT**

BORA MUZHAQI



**METODOLOGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT PËR REALIZIMIN E
THIRRJES VJETORE TË PROGRAMIT KOMBËTAR TË
PRAKTIKAVE TË PUNËS**

1. Puna përgatitore për planifikimin e nevojave

1. Institucionet pjesëmarrëse në program i komunikojnë ministrisë përgjegjëse për rininë personat e kontaktit për programin, numrin e praktikantëve të kërkuar dhe profilet e tyre studimore.
2. Ministria përgjegjëse për rininë mbledh dhe plotëson të dhënat për të gjitha institucionet pjesëmarrëse në program.
3. Ministria përgjegjëse për rininë përgatit materialet për publikim në platformën elektronike: <https://praktika.riniafemijet.gov.al>.
4. Ministria përgjegjëse për rininë mban komunikimin me personat e kontaktit për të gjitha institucionet, pjesëmarrëse në program.
5. Kryeministria, ministritë e linjës, institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e tjera publike, përmes personave të kontaktit për programin, mbikëqyrin dhe udhëzojnë institucionet e tyre të varësisë për mbarëvajtjen e procesit të përzgjedhjes së aplikantëve dhe zbatimit të programit.

2. Përgatitja dhe shpallja e thirrjes së aplikimit

1. Ministria përgjegjëse për rininë shpall thirrjen për aplikim dhe aktivizon platformën *on-line* të aplikimit: <https://praktika.riniafemijet.gov.al>.
2. Thirrja e aplikimit realizohet nga ministria përgjegjëse për rininë, në bashkëpunim me institucionet e tjera, pjesëmarrëse në program.
3. Shpallja e thirrjes u dërgohet institucioneve pjesëmarrëse në program, të cilat e publikojnë në faqet e tyre zyrtare dhe median sociale.
4. Thirrja qëndron e hapur për 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike.
5. Ministria përgjegjëse për rininë mund të zgjasë afatin e aplikimit në thirrje kur vlerësohet e nevojshme për mbarëvajtjen e procesit të aplikimeve.

6. Ministria përgjegjëse për rininë organizon takime informuese për thirrjen me studentë, të rinj, institucione pjesëmarrëse në program, organizata rinore, organizata për të rinjtë etj.

3. Kohëzgjatja e praktikës në thirrjen vjetore

Praktika në thirrjen vjetore të programit fillon të hënën e tretë të muajit shtator dhe zgjat 3 (tre) muaj.

4. Procesi i aplikimit

1. Aplikimi kryhet në platformën zyrtare të programit:
<https://praktika.riniafemijet.gov.al>.
2. Në platformën e aplikimit publikohen profilet studimore të kërkuara nga institucionet pjesëmarrëse në program, me qëllim orientimin e aplikantëve.

5. Format i aplikimit

Në formatin e aplikimit kërkohen të dhënat, si më poshtë vijon:

- a) Të dhënat personale;
- b) Studimet e përfunduara;
- c) Përcaktimi i mesatares së notave të programit të përfunduar të studimeve, përmes të cilit aplikanti po kandidon;
- ç) Jetëshkrimi;
- d) Letra e motivimit, në të cilën shpjegohet se si praktika në institucionin përkatës do të ndikonte në rritjen profesionale të aplikantit.

6. Shqyrtimi paraprak i aplikimeve

1. Ministria përgjegjëse për rininë ngre një komision të posaçëm për shqyrtimin paraprak të aplikimeve.
2. Komisioni i posaçëm shqyrton aplikimet e dorëzuara në thirrje për plotësimin e kriterëve, si vijon:
 - a) Dërgimi i aplikimit brenda afatit të përcaktuar;
 - b) Plotësimi i kriterit të moshës nga aplikanti;
 - c) Deklarimi i aplikantit si i diplomuar;
 - ç) Deklarimi i aplikantit si pjesëmarrës për herë të parë në program;
 - d) Deklarimi i aplikantit si i papunësuar në institucionet e administratës shtetërore në të shkuarën, me përjashtim të punësimit që lidhet me

kryerjen e veprimtarive administrative, të sekretarisë, mirëmbajtjes, shërbimit, ruajtjes dhe mosushtrimit të një funksioni publik;
(dh) Dorëzimi i dokumentacionit të përcaktuar në thirrje.

3. Komisioni i posaçëm vendos skualifikimin e çdo aplikimi kur konstaton se ka mangësi dokumentacioni apo mospërputhje me kriteret paraprake të thirrjes.

4. Komisioni i posaçëm harton një raport të detajuar mbi procesin e zhvilluar dhe ia paraqet ministrisë përgjegjëse për rininë.

5. Aplikimet, të cilat rezultojnë në përputhje me kriteret paraprake të thirrjes, i përcillen institucioneve përkatëse për vlerësim të mëtejshëm.

4. Ngritja e komisioneve përzgjedhëse *MA + S. m. t. e V. g. r. e. s. e*

1. Institucionet pjesëmarrëse në program ngrenë komisionet përzgjedhëse përpara mbarimit të afatit të aplikimit.

2. Kryeministria, ministritë e linjës, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore përcaktojnë nëse përzgjedhja e aplikantëve për institucionet në varësi të tyre do të realizohet në mënyrë të qendërzuara prej tyre apo përmes komisionit përzgjedhës, të ngritur pranë institucionit të varësisë.

3. Komisioni përbëhet nga të paktën 3 (tre) anëtarë.

4. Personi i kontaktit i caktuar për programin është anëtar në komisionin përzgjedhës të institucionit.

5. Personi i kontaktit i caktuar për programin në një institucion epror udhëzon dhe mbështet personat e kontaktit të institucioneve të varësisë në procesin e ngritjes dhe funksionimit të komisioneve përzgjedhëse.

8. Komunikimi i aplikimeve

1. Ministria përgjegjëse për rininë u dërgon në format elektronik aplikimet e marra në platformë personave të kontaktit të institucioneve pjesëmarrëse, brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga miratimi i raportit të shqyrtimit paraprak të aplikimeve nga ministri.

2. Kryeministria, ministritë e linjës, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore përcjellin aplikimet tek institucionet e tyre të varësisë, që kanë ngritur komisione përzgjedhëse.

9. Përzgjedhja e kandidatëve fitues

Vlerësimi: Vlerësimi maksimal për aplikantin është 40 pikë dhe përcaktohet, si më poshtë vijon:

a) Vlerësimi për nivelin e diplomës:

- | | | |
|------|---|------------|
| i. | "Bachelor" ose ekuivalent i tij | - 5 pikë; |
| ii. | "Master profesional" ose ekuivalent i tij | - 10 pikë; |
| iii. | "Master shkencor" ose ekuivalent i tij | - 15 pikë; |

b) Vlerësimi për mesataren e notave:

- | | | |
|------|------|------------|
| i. | 5-6 | - 5 pikë; |
| ii. | 7-8 | - 10 pikë; |
| iii. | 9-10 | - 15 pikë. |

c) Letra e motivimit vlerësohet nga 1 deri në 10 pikë.

Përzgjedhja:

1. Përzgjedhja e aplikantëve mbështetet në profilet studimore të kërkuara nga institucioni, të cilat shpallen në platformën e aplikimit për thirrjen vjetore.
2. Komisioni kryen vlerësimin e aplikantëve dhe harton listën rendore të tyre sipas pikëzimit, të ndarë sipas profileve studimore.
3. Në listë shënohen dhe aplikantët në pritje, të renditur sipas pikëzimit dhe profileve studimore, që do të zëvendësojnë aplikantët e përzgjedhur, në rast tërheqjeje nga programi apo në rast skualifikimi.
4. Komisioni harton listën paraprake të përzgjedhjes së aplikantëve, sipas profileve studimore, brenda 3 (tri) ditëve punë nga administrimi i aplikimeve.

10. Njoftimi i fituesve

1. Personi i kontaktit në institucion njofton aplikantin e përzgjedhur për datën e paraqitjes në institucion dhe dokumentacionin që dorëzohet për verifikim, brenda 2 (dy) ditëve punë nga vlerësimi i komisionit.
2. Personi i kontaktit në çdo institucion verifikon të dhënat e deklaruara në aplikim.
3. Aplikanti skualifikohet në rast se nga verifikimi i të dhënave rezulton të ketë pasaktësi thelbësore në deklaratimet e tij.
4. Në rast skualifikimi apo tërheqjeje nga programi, personi i kontaktit njofton aplikantin e renditur në radhë sipas pikëzimit, me të njëjtin profil studimor, sipas listës së hartuar nga komisioni.
5. Institucionet pjesëmarrëse në program miratojnë listat përfundimtare të përzgjedhjes së aplikantëve dhe i përcjellin përmes postës elektronike, pranë ministrisë përgjegjëse për rininë, brenda 7 (shtatë) ditëve punë nga përmbyllja e procesit të përzgjedhjes. Në listë pasqyrohet renditja, sipas pikëzimit dhe profileve studimore:
 - a) të aplikantëve të përzgjedhur;
 - b) të aplikantëve të përzgjedhur pas procesit të rishpërndarjes, brenda të njëjtit sistem ministror;
 - c) të aplikantëve të papërzgjedhur;
 - ç) të aplikantëve të skualifikuar apo të tërhequr nga programi.
6. Institucionet pjesëmarrëse në program, kur rezulton të kenë ende vende vakante, përcjellin pranë ministrisë përgjegjëse për rininë, së bashku me listën përfundimtare të përzgjedhjes së aplikantëve, kërkesën për aplikantë shtesë dhe profilet e tyre studimore.

11. Procesi i rishpërndarjes

1. Në rast se një institucion nuk plotëson vendet e shpallura përmes aplikimeve të administruara, mund të kërkojë të mbështetet me aplikantë të tjerë nga lista e aplikantëve të papërzgjedhur të institucioneve të tjera, brenda të njëjtit sistem ministror. Ky proces koordinohet nga personat e kontaktit të këtyre institucioneve dhe përmbyllet brenda 2 (dy) ditëve punë nga finalizimi i listave të përzgjedhjes së aplikantëve nga institucionet.
2. Ministria përgjegjëse për rininë, pas verifikimit që numri maksimal i praktikantëve të parashikuar për t'u përzgjedhur në thirrjen publike nuk është plotësuar, koordinon rishpërndarjen e aplikantëve të papërzgjedhur

pranë institucioneve që rezultojnë me vakanca, brenda 3 (tri) ditëve punë nga administrimi i listave përfundimtare të përzgjedhjes së aplikantëve dhe kërkesave shitesë të institucioneve.

3. Institucionet përzgjedhin aplikantët nga lista e rishpërndarë, sipas metodologjisë së përcaktuar në pikën 10, të këtij dokumenti, dhe njoftojnë fituesit brenda 2 (dy) ditëve punë nga administrimi i aplikimeve shitesë.

12. Angazhimi i praktikantit në orë pune

1. Praktikanti do të kryejë praktikën e punës pranë institucionit ku është pranuar, çdo ditë, nga e hëna deri të premten, me kohëzgjatje 6 (gjashtë) orë, brenda orarit zyrtar.
2. Praktikanti, për t'u certifikuar për përfundimin me sukses të programit, duhet të ketë marrë pjesë, të paktën, në 80 % të zhvillimit të praktikës.

13. Fillimi i programit të praktikës

1. Praktikanti i përzgjedhur dorëzon te personi i kontaktit në institucionin pritës, brenda 10 (dhjetë) ditëve pas fillimit të programit, jetëshkrimin, fotokopjen e ID-së, kopjen e noterizuar të diplomës së studimeve të përfunduara, kopjen e noterizuar të listës së notave të studimeve të përfunduara ose një vërtetim zyrtar për përfundimin e programit të studimit, i shoqëruar me listën e notave, të lëshuar nga institucioni përkatës i arsimit të lartë.
2. Pas administrimit të dokumentacionit, por jo më vonë se 14 (katërmëdhjetë) ditë kalendarike nga fillimi i programit, nënshkruhet marrëveshja midis institucionit pritës dhe praktikantit për zhvillimin e praktikës.
3. Marrëveshja tip hartohet nga ministria përgjegjëse për rininë.
4. Personi i kontaktit në çdo institucion koordinon procesin e caktimit të një mbikëqyrësi për secilin praktikant, i cili përmbush kriteret dhe përgjegjësitë e përcaktuara në pikën 5, të nenit 4, të kreut II, të këtij vendimi.

14. Përfundimi i praktikës 3-mujore

1. Ministria përgjegjëse për rininë përgatit dhe shpërndan pranë institucioneve pjesëmarrëse formularin tip të vlerësimit të praktikantit nga mbikëqyrësi dhe formularin tip të vlerësimit të mbikëqyrësit nga praktikanti.
2. Formularët e vlerësimit të praktikantëve nga mbikëqyrësit dhe formularët e vlerësimit të mbikëqyrësve nga praktikantët plotësohen gjatë javës së fundit të zhvillimit të praktikës 3 (tre)-muajore.
3. Ministria përgjegjëse për rininë harton formatin e certifikatës për praktikantët që përmbyllin me sukses programin.
4. Ministria përgjegjëse për rininë verifikon me çdo institucion pjesëmarrës listën e praktikantëve që kanë kryer me sukses praktikën 3 (tre)-muajore në program.
5. Ministria përgjegjëse për rininë, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, përgatit certifikatën për çdo praktikant që përmbyll me sukses programin dhe dërgon certifikatat pranë institucioneve pjesëmarrëse.
6. Institucionet pjesëmarrëse realizojnë shpërndarjen e certifikatave të praktikantëve të tyre.

15. Përzgjedhja e praktikantëve për punësimin me kontratë pune 1 (një)-vjeçare

1. Institucionet pjesëmarrëse në program përcaktojnë numrin e praktikantëve që do të punësohen me kontratë pune 1 (një) - vjeçare dhe kryejnë procedurat e përzgjedhjes së tyre, brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga përfundimi i praktikës 3 (tre) - muajore.
2. Institucionet pjesëmarrëse në program hartojnë listat rendore të praktikantëve, në bazë të pikëve të akorduara nga mbikëqyrësit në formularët e vlerësimit të praktikantëve.
3. Institucionet pjesëmarrëse në program përzgjedhin praktikantët e renditur më lart, në bazë të pikëzimit dhe i ofrojnë atyre kontratat e punës. Në rast tërheqjeje të praktikantit, kontrata i ofrohet praktikantit të renditur në radhë, sipas pikëzimit.

16. Fillimi i periudhës së punësimit dhe raportimi

1. Kryeministria, ministritë e linjës, institucionet e pavarura dhe njësitë e

vetëqeverisjes vendore, pjesëmarrëse në program, dërgojnë pranë ministrisë përgjegjëse për rininë numrin e praktikantëve që do të punësohen me kontratë pune I (një)-vjeçare në këto institucione dhe në institucionet e tyre të varësisë, brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve punë nga përfundimi i praktikës 3 (tre)-muajore.

2. Ministria përgjegjëse për rininë përcakton datën e fillimit të marrëdhënieve financiare dhe të punës për praktikantët në thirrjen vjetore të programit, që është e njëjtë për të gjitha institucionet pjesëmarrëse, pas marrjes së konfirmimit për çeljen e fondeve nga ministria përgjegjëse për financat.
3. Personat e kontaktit për programin në Kryeministri, ministritë e linjës, institucione të pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore grumbullojnë dhe përcjellin pranë ministrisë përgjegjëse për rininë të dhënat për praktikantët e punësuar dhe listat e vlerësimit për punësimin e praktikantëve nga këto institucione dhe institucionet e tyre të varësisë, brenda 5 (pesë) ditëve punë nga nënshkrimi i kontratave të punës me praktikantët,

NR.PROT. 2228/13
DATË 4. 6 .2025

TË GJITHA MINISTRIVE
TË GJITHA BASHKIVE
AGJENCISË KOMBËTARE TË RINISË
DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE
SHKOLLËS SHQIPTARE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

Në mungesë dhe me porosi

Herald JONUZAJ

